

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Mix+

ADITIV PËR PLASTIFIKIMIN E LLAÇIT



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Mix+ është aditiv i lëngshëm gati për përdorim për llaçin dhe suvanë. Redukton ndjeshëm konsumimin e gëlqeres, rrit punueshmërinë dhe përmirëson cilësinë e llaçeve dhe suvave. Produkti mbart markën CE si aditiv llaçi për muret.

PËRDORIMET

- Për prodhim llaçi dhe suvaje me cilësi të lartë me punueshmëri dhe rezistenca të shtuara

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Gati për përdorim
- Përmirëson procesin e hidratimit dhe prodhon suva me cilësi të lartë për mure, mure me tulla dhe veshje
- Shton rezistencën ndaj ngricave
- Redukton plasaritjet
- Ndërkapje e përmirësuar
- Shumë ekonomik
- Shton punueshmërinë dhe ofron konsistencë dhe plasticitet më të mëdha
- Kohë e përmirësuar mpiksjeje
- Përdorim shumë i lehtë
- Nuk përmban klorure apo substanca të tjera korroduese

MIRATIME / STANDARDE

Aditiv ajër-futës / plastifikues (Tabela 2) sipas EN 934.03:2009+A1:2012, Deklaratë Performance 53023840 dhe mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Solucion ujq surfaktantësh
Ambalazhi	IBC, fuçi 220 kg bidon plastik 1, 5 dhe 20 kg Furnizim rifuxho me porosi.
Paraqitja / Ngjyra	Lëng, kafe
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal të padëmtuar dhe të pahapur në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +35°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe ngrica.
Dendësia	~ 1.02 kg/l (në +20°C)
Vlera e pH	8.0 – 11.0 (në +20°C)
Përmbajtja totale e joneve të klorurit	Nuk ka (EN 934.01)

TË DHËNA TEKNIKE

Këshilla specifike

Pastroni dhe ashpëroni sipërfaqen e betonit. Në rast nënshtrese guri, hiqni të gjitha grimcat e lira. Nënshtresa duhet të ngopet me ujë, por pa pëllg ujë mbi sipërfaqe.

Përbërja e betonit

Llaç për suvatim

Shtoni Sika® Mix+ (dhe Sika® Latex Max) brenda ujit të pastër dhe këtë përzierje shtoheni tek përzierja rërë / çimento. Zakonisht ndiqet kjo recetë: raporti çimento: rërë ~ 1:3, ~3 kg gëlqere, 100 gr Sika® Mix+, max. 5 kg Sika® Latex Max dhe sasia e kërkuar e ujit.

Llaç për mure

Shtoni Sika® Mix+ (dhe Sika® Latex Max) brenda ujit të pastër dhe këtë përzierje shtoheni tek përzierja rërë / çimento. Zakonisht ndiqet kjo recetë: raporti çimento: rërë ~ 1:3, ~3 kg gëlqere, 150 gr Sika® Mix+, 2-4 kg Sika® Latex Max dhe sasia e kërkuar e ujit.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Doza e rekomanduar

Llaç për suvatime: 0.1 – 0.2% të peshës së çimentos (50-100 gr / 50 kg çimento)

Llaç për mure: 0.3% të peshës së çimentos (150 gr / 50 kg çimento)

Kufizime

- Sika® Mix+ zgjat kohën e mpiksjes, prodhon llaç të butë e plastik dhe përmirëson fluiditetin e miksit. Si pasoje, Sika® Mix+ redukton rrezikun e mpiksjes dhe bllokimit të linjës së tubave të pompave për hedhjen e llaçit dhe lejon shtimin e dozës së Sika® Latex Max.
- Sika® Latex Max i jep llaçit të suvatimit veti të shkëlqyera, në lidhje me adezionin, rezistencat, papërshkueshmërinë, redukton koston e prodhimit të llaçit dhe redukton rrëzimin e suvasë gjatë aplikimit. Sika® Mix+ bën të mundur shtimin e deri në 5 kg Sika® Latex Max / 50 kg çimento, duke krijuar kështu një përzierje shumë cilësore, hidroizoluese, dhe ekonomike. Për më shumë informacione, referohuni tek skeda teknike e Sika® Latex Max.
- Përpara të gjitha aplikimeve, duhet të kryhen testime përshtatshmërie pasi, prodhimi i përzierjes më të mirë varet nga parametra të ndryshëm si cilësia e rërës, temperatura, lageshtia etj.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sika® Mix+
Shkurt 2019, Botimi 01.01
021303011000000189

SikaMix+-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf

